

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Pitbulli" në dosjen e kokainës/ Kush është Sokol Bibaj dhe lidhja me Salvadore Aliun
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1394503.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 14:27:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	27 shtator 2026, 14:24:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 27 shtator 2026, 14:23:00 UTC → 27 shtator 2026, 14:25:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	20cb0fb957aa6790b9e5f954704276c60c14928d423dc30be4b40984fce35c9e
TEKSTI	5675ff85fb2ff11a0cb8ae166dab1de13edebff417b6c90fdd2712caadfdc20f
PAMJA	5d37cbf8813dcdb4821dbacda4919f9e2b094908fce219c6655c11fc4ec1ecdb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1cc4e4466921e4066ac583198f19ba691fd1aa32ddbfcc2085cf8e92b04f36403
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3dbf5264f26ae921c8f8735760cb378b1b626a14b73f487ffe641eb8f02fca55
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1cc4e4466921e4066ac583198f19ba691fd1aa32ddbfcc2085cf8e92b04f36403>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Pitbull” në dosjen e kokainës/ Kush është Sokol Bibaj dhe lidhja me Salvatore Aliun

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 27.09.2026, 16:24

Share

Share



Sokol Bibaj, i njohur me nofkat “Gus”, “Gusti” dhe “Pitbull”, është një prej personave të shpallur në kërkim në kuadër të një hetimi të SPAK për një grup të dyshuar kriminal, i cili dyshohet se ishte i përfshirë në trafikun ndërkombëtar të kokainës nga Amerika Latine drejt vendeve të Europës.

Për Bibajn, Gjykata e Posaçme ka caktuar masën e sigurisë “arrest në burg”. Sipas akuzave të ngritura në kuadër të hetimit, ai dyshohet për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike, pastrim parash dhe pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal.

Emri i Bibajt është përfshirë në të njëjtën dosje hetimore me disa persona të tjerë, mes tyre Shpëtim Aliu, i njohur si “Salvatore”, Dritan Gjika, Denis Matoshi alias “Eldi Dizdari”, Nikoll Bibaj, Isa Aliu, Florjan Musaj, Naldi Yzeiraj, Armando Pacani dhe Oklid Aliu.

Sipas të dhënave të përfshira në dosjen e hetimit, Sokol Bibaj dyshohet se kishte një rol të rëndësishëm në organizimin e aktivitetit kriminal dhe se siguronte lëndën narkotike përmes Shpëtim Aliut. Ky i fundit është arrestuar në Rusi, pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, ndërsa autoritetet shqiptare kanë nisur procedurat për ekstradimin e tij.

Një pjesë e rëndësishme e hetimeve mbështetet në komunikimet e zhvilluara përmes platformës së enkriptuar Sky ECC. Sipas SPAK, analizimi i këtyre komunikimeve ka ndihmuar në identifikimin e kontakteve dhe lidhjeve mes personave të dyshuar, ndërsa Bibaj përmendet në disa episode që lidhen me transportin dhe sigurimin e sasive të dyshuara të kokainës.


Në dosje është përfshirë edhe vëllai i tij, Nikoll Bibaj, i njohur me nofkat “Buci” dhe “Ujku”.

Një nga episodet e përshkruara nga hetuesit lidhet me një komunikim zanor të regjistruar më 31 maj 2020. Sipas përmbajtjes së dosjes, Sokol Bibaj i ka rrëfyer të vëllait se autoritetet kishin shpërndarë fotografinë e tij në Shkup dhe kishin arritur të identifikonin personin. Gjatë bisedës, ai ka folur edhe për një ndalim të mëparshëm, ndërsa ka pretenduar se të dhëna për të ishin përcjellë nga një ish-unonjës i strukturave që hetonin krimin e organizuar.

Në fokusin e hetimit janë pesë episode kryesore të dyshuara të trafikut të narkotikëve. Sipas versionit të SPAK, në drejtimin e grupeve të përfshira dyshohet se kanë qenë persona si Eldi Dizdari, Dritan Gjika dhe Armando Pacani, ndërsa Shpëtim Aliu dyshohet se kishte një rol të rëndësishëm në sigurimin e lëndës narkotike.

Hetimi i Prokurorisë së Posaçme shtrihet edhe te gjurmimi i të ardhurave që dyshohet se janë krijuar nga aktiviteti i paligjshëm. Sipas akuzës, një pjesë e parave dyshohet se është futur në Shqipëri në mënyrë fizike, pa kaluar përmes kanaleve bankare.

Më tej, këto të ardhura dyshohet se janë përdorur për investime në pasuri të



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

paluajtshme dhe në aktivitete të ndryshme ekonomike, përfshirë kompani tregtare, ndërtim, hoteleri dhe shërbime konsulence.

Hetimet për dokumentimin e plotë të skemës, burimit dhe destinacionit të parave, si dhe rolin konkret të secilit prej personave të përfshirë, vijojnë.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.